

VENDIM
Nr. 37, datë 3.8.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR VEPRIMET ME FONDET NË VLERA MONETARE NË BANKËN E SHQIPËRISË”, E NDRYSHUAR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c”, dhe kreut V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për veprimet me fondet në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 56, datë 6.8.2015, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 4, pika 1, shkronja “i”, shprehja *“10/20 fishekë-rulon për monedhat metalike”* zëvendësohet me shprehjen *“paketimi i një sasive prej 500 copë monedhash metalike i përbërë nga 10/20 fishekë-rulonë”*;

b) në nenin 4, pika 1, shkronja “j”, fjalia e dytë, shprehja *“arkave ose pakove të kartonit të ardhura nga prodhimi”* zëvendësohet me shprehjen *“arkave me 20 mijë copë kartëmonedha të ardhura nga prodhimi ose pakove të kartonit me një mijë copë monedha metalike të ardhura nga prodhimi ose përpunimi.”*;

c) në nenin 14, pika 4, shkronja “a”, shprehja *“prej 5000 lekë”* zëvendësohet me shprehjen *“prej 5000 lekë dhe/ose 10000 lekë”*;

d) në nenin 14, pika 4, shkronja “b” ndryshon përmbajtje si vijon:

“numri i monedhave metalike, për çdo prerje, të plotpjesëtohet me 1000”;

e) në nenin 15, pika 2, shkronja “b/i” ndryshon përmbajtje si vijon:

“monedhat metalike paketohen sipas prerjeve në fishekë-rulonë letre me përbërje prej 25 ose 50 monedhash metalike, sipas përcaktimeve në nenin 10 të kësaj rregulloreje. Fishekë-rulonët paketohen në koli pako kartoni me nga 1000 monedha metalike. Kolia pako kartoni është e vulosur me vulë datare dhe e firmosur nga punonjësit që kryejnë mbylljen e saj.”;

f) në nenin 15, pika 2, shkronja “b/ii” ndryshon përmbajtje si vijon:

“në rastin kur paketimi në fishekë-rulon dhe/ose koli pako kartoni nuk është i mundur, monedhat metalike paketohen sipas prerjeve në koli (thes bezeje) me përbërje prej të paktën 1000 copë monedhash metalike. Kolitë mbyllen duke iu vendosur një etiketë ku janë shënuar prerja dhe sasia e monedhave të cilat janë të vendosura brenda në koli, shenja e mbylljes, si edhe data kur mbyllet kolia. Etiketa nënshkruhet nga punonjësit që kanë kryer mbylljen e kolisë.”;

g) në nenin 15, pika 2, shkronja “b/iii” shfuqizohet.

2. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko